



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 shkurt 2015
Nr. ref.:RK768/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI136/14

Parashtrues

Abdullah Bajqinca

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 99/2014,
të 12 majit 2014**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Abdullah Bajqinca, me vendbanim në Bardh të Madh, komuna e Fushë-Kosovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga znj. Fehmije Bytyqi-Gashi, avokate në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 99/2014, të 12 majit 2014, me të cilin ishte ndryshuar Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 1870/2012, i 21 gushtit 2013, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 2146/2009, i 22 prillit 2010.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, që pretendohet të ketë shkelur nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji)

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 9 shtator 2014, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 tetor 2014, Kryetari caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 20 tetor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 9 dhjetor 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, ta deklarojë kërkesën të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës ishte punëtor në Departamentin e Mirëmbajtjes së Qymyrit-KEK (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) prej 1 tetorit 2006.
10. Më 16 maj 2007, punëdhënësi suspendoi nga puna parashtruesin e kërkesës për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale të vjedhjes së pasurisë së punëdhënësit.
11. Pas atij suspendimi, u iniciuan procedurat administrative, penale dhe kontestimore.

Procedura administrative

12. Më 27 korrik 2007, Komisioni Disiplinor i Punëdhënësit vendosi të ndërpresë marrëdhënien e punës me parashtruesin e kërkesës, për shkak të shkeljes së detyrave të punës.
13. Më 31 korrik 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë te organi disiplinor i shkallës së dytë i punëdhënësit kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të Punëdhënësit.
14. Më 6 gusht 2007, shkalla e dytë refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi vendimin e Komisionit Disiplinor.

Procedura penale

15. Më 27 shkurt 2009, Gjykata Komunale në Prishtinë (Aktgjykimi P. nr. 2287/07) liroi parashtruesin e kërkesës nga akuza për vjedhje të pasurisë së punëdhënësit. Vendimi për lirim ishte i formës së prerë dhe detyrues.

Procedura kontestimore

16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Komunale, për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës.
17. Më 22 prill 2010, Gjykata Komunale (Aktgjykimi, C. nr. 2146/09) miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës, anuloi vendimet e dy organeve disiplinore të punëdhënësit dhe detyroi punëdhënësin ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës.
18. Gjykata Komunale konkludoi se vendimet e dy organeve disiplinore të punëdhënësit ishin nxjerrë me shkelje të ligjit në fuqi, sepse “[...] siç rezulton nga aktgjykimi penal teli për marrjen e të cilit ngarkohet paditësi dhe për çka ai akuzohet (...) nuk i ka tiparet e veprës së vjedhjes”.
19. Punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar shkelje të procedurës, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
20. Më 21 gusht 2013, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi CA. nr. 1870/2012), refuzoi si të pabazuar ankesën e punëdhënësit dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale, të 22 prillit 2010.
21. Pas kësaj, punëdhënësi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje esenciale të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 12 maj 2014, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Rev. nr. 99/2014) miratoi revizionin e punëdhënësit si të bazuar dhe ndryshoi aktgjykimet e gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë.

23. Gjykata Supreme konstatoi se “gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale”.
24. Në fakt, Gjykata Supreme ka sqaruar “Paditësit iu është shkëputur marrëdhënia e punës për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës, vjedhje të pasurisë së të paditurës, nga neni 6 al. 1 pika 4 të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorëve të KEK-ut. Nga ana e të paditurës është zhvilluar procedura disiplinore në kuptim të dispozitave të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale dhe në këtë procedurë është vërtetuar përgjegjësia e paditësit, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore – ndërprerjes së marrëdhënies së punës ndaj paditësit nga ana e të paditurit, janë respektuar dispozitat nenit 112 të Ligjit të marrëdhënies së punës, i cili ka qenë Ligj i aplikueshëm në momentin e zbatimit të procedurës disiplinore ndaj paditësit. Gjykata në këtë çështje juridike nuk mund të lëshohet në faktin e ekzistimit apo mosekzistimit të veprës disiplinore pasi që kjo vërtetohet në procedurën e zhvilluar te punëdhënësi. Nga provat që ekzistojnë në shkresat e lëndës del se procedura disiplinore te e paditura kundër paditësit, është zhvilluar në kuptim të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale si dhe Ligjit të punës që ka qenë në fuqi”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi nuk paraqet ndonjë pretendim për shkelje kushtetuese, ai vetëm pohon “[...] sipas vendimit të fundit të Gjykatës Supreme pretendohet se i është shkelur e drejta themelore e kjo e përcaktuar me Kushtetutë, sipas nenit 49 dhe 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.
26. Parashtruesi më tej kërkon nga Gjykata të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme (Rev. nr. 99/2014, të 12 majit 2014).

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 48 të Ligjit, i cili parasheh:

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

29. Përveç kësaj, Gjykata i referohet rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili parasheh:

(2) “Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

...

(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”.

30. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
31. Megjithatë, parashtruesi nuk ngre asnjë pretendim për shkeljen e të drejtave kushtetuese siç pohon ai.
32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, nuk është i kënaqur, kryesisht me kualifikimin juridik të fakteve dhe të ligjit të aplikuar nga Gjykata Supreme. Kualifikimi juridik i fakteve dhe ligji i aplikueshëm janë çështje të cilat bien në sferën e ligjshmërisë.
33. Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ose vetëm përmendja e nenit 49 dhe 55 të Kushtetutës nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës.
34. Në të vërtetë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thirret në nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës. Megjithatë, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si e tillë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit që do të arsyetonte përfundimin se është shkelur e drejta e tij kushtetuese për punë.
35. Gjykata vëren se Gjykata Supreme konkludoi, gjegjësisht *“procedura disiplinore te e paditura kundër paditësit, është zhvilluar në kuptim të Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale si dhe Ligjit të punës që ka qenë në fuqi”*.
36. Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria).
37. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë që procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejta të Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
38. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka shpjeguar si dhe pse përfundimi i Gjykatës Supreme për "ligjin e zbatueshëm në atë kohë", në rastin e tij ka shkelur të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, dhe as që ka pretenduar ndonjë padrejtësi dhe arbitraritet në procedurë.
39. Përveç kësaj, Gjykata rithekson që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, që të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga

gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin Nr. KI70/11, parashtrues *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011)

40. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur një pretendim për shkelje kushtetuese dhe as nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
41. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar, dhe rrjedhimisht e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (2) d) dhe 56 (b) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani